



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Buletin i aktiviteteve për muajin Tetor-2024

01 tetor 2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), agjencisë zvicerane Swiss-Contact dhe Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor, për të biseduar për avancimin e projektit për ndërtimin e strukturës dhe teleferikut për ngjitje në Kalanë e Prizrenit.

Studimi i fizibilitetit ka përfunduar, ndërsa, në takimin e sotëm u diskutuan hapat e mëtejshëm për hartimin e projektit të detajuar implementues.

Marrëveshja për këtë projekt buron nga një bashkëpunim tripalësh mes Komunës së Prizrenit, MMPHI-së dhe agjencisë zvicerane Swiss-Contact.

Ky projekt do ta lehtësoj qasjen në Kalanë historike, një nga atraksionet më të rëndësishme turistike të qytetit.



1 tetor 2024

Kryetari Shaqir Totaj, takoi sot Presidentin e "Democracy International", z. Eric Bjornlund, partner implementues i USAID Kontrata Sociale, ku bisedoi për shumë çështje me interes, përfshirë dhe suksesin e projektit Kontrata Sociale.

Poashtu takoi dhe stafin lokal të USAID-it me të cilët ka një bashkëpunim shumëdimensional.



2 tetor 2024

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka filluar zbatimin e projektit "Ngritja e Serrave - me participim", që ka për qëllim t'u mundësojnë fermerëve të Komunës së Prizrenit rritjen e kapacitetit të prodhimit dhe përmirësimin e kushteve të tyre të punës.



3 tetor 2024

Në qershor, banorët e lagjes Ortakoll zgjodhën projektin për renovimin e SHFMU "Hysen Rexhepi", me votë të lirë, përmes procesit të buxhetimit me pjesëmarrje, me ç'rast ky projekt do të financohet nga Komuna me 100 mijë euro, me përkrahjen e USAID-it Kontrata Sociale.

 Projekti i përzgjedhur është përfshirë në buxhetin e Komunës së Prizrenit, ndërsa, për më shumë informata, vizitoni vegëzën e mëposhtme të buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, ku, banorët e lagjes Ortakoll mund ta gjejnë projektin dhe investimet tjera kapitale që do të realizohen vitin e ardhshëm.



4 tetor 2024

Nënkryetari Kujtim Gashi, së bashku me ekipin nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik e udhëhequr nga drejtori Ramadan Tarashaj, zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të gastronomisë nga Prizreni, po marrin pjesë në Festivalin Global Shqiptar të Gastronomisë që po mbahet në Berlin të Gjermanisë.

 Në panelin e organizuar me këtë rast, nënkryetari Gashi prezantoi produktet e gastronomisë së Prizrenit në këtë festival unik i cili u jep mundësi bizneseve shqiptare që t'i promovojnë recetat dhe produktet kombëtare si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe të gjenerojnë drejtime të reja biznesi.

 Në këtë aktivitet, gastronomët dhe prodhuesit tanë po krijojnë ura të reja bashkëpunimi me biznese ndërkombëtare, duke shfrytëzuar potencialin e diasporës shqiptare dhe fuqinë e produkteve vendore.

 Ky aktivitet do të krijojë mundësi të reja eksporti për produktet shqiptare dhe do të ndihmojë në rritjen e ndikimit të gastronomisë shqiptare në tregun global.



5 tetor 2024

Pas shumë vitesh, në fshatin Medvec, ka përfunduar renovimi i plotësishëm i sallës sportive që do t'i shërbej nxënësve dhe komunitetit në përgjithësi.

 Ky projekt i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është një mundësi për të rinjtë dhe banorët e Medvecit për përfshirjen në aktivitete sportive, sociale dhe shëndetësore.




7 tetor 2024

Drejtoria e Inspektorateve ka ndërmarrë aksion për largimin e objekteve të përkohshme (tendave) të vendosura në hapësira publike pa lejen e organeve kompetente komunale në subjekte afariste, në rrugën “Adem Jashari” në Prizren.

Kërkohet nga të gjithë qytetarët, pronarë të subjekteve afariste, që të mos vendosin objekte të përkohshme si: tenda, konstruksione metalike dhe të ngjashme pa leje të organeve kompetente komunale, pasi, Drejtoria e Inspektorateve obligohet t'i largojë ato, përmes operatorit ekonomik të kontraktuar nga Komuna e Prizrenit, në barë të pronarëve të subjekteve afariste.

Ju faleminderit për mirëkuptim!



8 tetor 2024

Kryetari Shaqir Totaj, së bashku me shefin e UNDP-së në Kosovë, Nuno Queiros, morën pjesë sot në eventin përmbyllës të projektit “Forcimi i Veprimit Lokal të Klimës”, ku u prezantuan të arriturat kryesore, projekt që është financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) dhe është zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, në Komunën e Prizrenit dhe atë të Suharekës.

Me këtë rast u mbajt edhe ceremonia e dorëzimit të certifikatave të mirënjohjes për anëtarët e Qendrave Komunale të Rritjes së Gjellbër (QMGC) nga të dyja komunat, për kontributin e tyre në suksesin e projektit.



10 tetor 2024

Nënkryetari Kujtim Gashi, nënshkroi protokollin e bashkëpunimit me Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, i cili synon t'i avancoj përpjekjet për mbledhjen e materialeve që dokumentojnë krimet e kryera gjatë luftës.



10 tetor 2024

Nën mbështetjen e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, organizuar nga Shoqata për Kulturë “Plejada”, në Kinemanë Lumbardhi u mbajt edicioni i nëntë i festivalit multi-etnik të këngëve tradicionale dhe folklorit “BallkanFest 2024– Republika e Kosovës”.

Sivjet, festivali tuboi pjesëmarrës nga të gjitha komunitetet e Kosovës - mbi 300 interpretues nga shoqëritë kulturore dhe artistike nga vendet e Ballkanit.

Qëllimi i këtij festivali është promovimi dhe ruajtja e këngëve tradicionale, folklorit, valleve, diversitetit kulturor dhe trashëgimisë kulturore si dhe përçon mesazh paqeje si në Kosovë ashtu edhe në mbarë Ballkanin.




11 tetor 2024

Filluan sot punimet për rrënimin e objektit të shpronësuar nga Komuna, ish objektit të ndërmarrjes “Liria”, që gjendet pas Shtëpisë së Bardhë në Prizren (Bazhdarhane) dhe janë duke u zhvilluar me intensitet të lartë. 🚧 ⏳

Ekipet e rrënitit janë duke e kryer procesin me kujdes të shtuar, duke u përqendruar në sigurinë e zonës përreth. ⚠️ 🧑‍🔧 🧑‍🔧

Ky projekt është pjesë e planeve të vazhdueshme për përmirësimin e infrastrukturës në qytet me prioritet funksionalizimin e rrugës Adem Jashari dhe lehtësimin e qarkullimit të përgjithshëm në trafik. 🗑️ 🔧



11 tetor 2024

Kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës (OVL), Bejtullah Bejtullahu nga UÇPMB si dhe shumë qytetarë ishin të pranishëm në ceremoninë e përrurimit të memorialit të komandant Xhavit Elshani, i njohur si “Leopardi”, në fshatin Piranë. 🌿

Ky memorial përkujton dhe nderon jetën dhe veprën e komandantit Elshani, duke e vlerësuar si një figurë të shquar në luftën për liri.




11 tetor 2024

Sot u bë përrurimi i sallës sportive në fshatin Medvec!

🏠 Ky investim i rëndësishëm do të shërbejë për zhvillimin e sporteve si volejbolli 🏐, futboli ⚽ dhe basketbolli 🏀.

Një hapësirë moderne që inkurajon aktivitetin fizik dhe mundësitë për të rinjtë e komunitetit!





12 tetor 2024

Kryetari Shaqir Totaj, i shoqëruar me zyrtarë të ekzekutivit, morën pjesë sonte në hapjen e edicionit të 21-të të Festivalit Ndërkombëtar të Stripit dhe Karikaturës në galerinë "Shani Efendi" në Prizren, që sivjet solli një numër të madh punimesh të realizuara nga artistë nga vende të ndryshme të botës, me temën “Stripi dhe Karikatura si Zhvillim Kulturor”.

Drejtori i këtij festivali, karikaturisti i talentuar prizrenas, Gani Sunduri, bëri të ditur se numri i përgjithshëm i punimeve në këtë edicion është 300, të cilat janë përzgjedhur për garën e ngushtë, derisa e veçanta e këtij viti është hapësira për artistët e rinj nën moshën 18 vjeçare, për ta shfaqur talentin e tyre.

Ky festival veçse e zbukuron mozaikun e festivaleve në Prizren dhe Komuna vazhdimisht do t'i mbështesë aktivitetet e këtilla kulturore.



16 tetor 2024

Kryetari Shaqir Totaj, së bashku me Ndhmës Sekretaren e Përgjithshme e Ndhmës Administratoren e UNDP-së dhe Drejtoreshë e Byrosë Rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore, Ivana Živković, shefin e UNDP-së në Kosovë, Nuno Queirós, Zëvendës Përfaqësuesin e Përhershëm të UNDP-së, Dudley Tarlton, shefin e bashkëpunimit në zyrën e BE-së në Kosovë, Johannes Stenbaek Madsen, shefen e zyrës së Agjencisë Austriake për Zhvillim, Rita Glavitz, si dhe me zyrtarë të ekzekutivit, bënë një shëtitje në qendër të Prizrenit dhe vizituan bizneset që janë pjesë e projektit të komunës “InMotion” bashkë me UNDP-në dhe panelet solare të vendosura në objektet e Komunës së Prizrenit, për t’i parë nga afër rezultatet e këtij projekti, Trashëgimisë Kulturore dhe SLCA-së.

"Gjithmonë kënaqësi të takosh miq dhe partnerë të çmuar si dhe t’i vizitosh prizrenasit e suksesshëm në biznese" - u shpreh Kryetari Totaj.



16 tetor 2024

Në Kinemanë Lumbardhi në Prizren u mbajt ngjarja muzikore “Harmonia e Kulturave”, i organizuar nga OJQ “Ballkan Arena” dhe i mbështetur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që bashkoi artistë të njohur vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët krijuan atmosferë të jashtëzakonshme për publikun.

🎨 Aktiviteti kulturor u shndërrua në një festë të vërtetë të harmonisë dhe diversitetit kulturor, duke thelluar kështu lidhjet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në Prizren.



21 tetor 2024

Në një ceremoni në Budvë, në emër të Kryetarit Shaqir Totaj, drejtori i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Rasim Demiri, pranoi çmimin e artë dhe mirënjohjen për punën e Komunës së Prizrenit në fushën e krijimit të një ambienti të mirë dhe klime për zhvillimin e ndërmarrësisë në Evropën Qendrore dhe Juglindore "GlobalLocal", i cili çmim jepet për rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore sipas vendimit të Komitetit Ndërkombëtar të pavarur për dhënien e çmimeve dhe mirënjohjeve nga Forumi Ndërkombëtar Ekonomik Perspektive, me mbështetjen e Kongresit Botëror të Ndërmarrësisë.

Komuna e Prizrenit ka fituar këtë çmim në konkurrencë me Austrinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut, Slloveninë dhe Serbinë, në mesin 89 kandidatëve, qyteteve dhe institucioneve.

"Çmime dhe mirënjohje të tilla në skenën ndërkombëtare janë motivim për të krijuar një klimë edhe më të favorshme për zhvillimin ekonomik" - u shpreh me këtë rast Kryetari Totaj.



24 tetor 2024

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, po vazhdon me realizimin e projekteve që përmirësojnë cilësinë e qytetarëve, duke rregulluar dhe meremetuar kulmet e banesave kolektive në Prizren.

📍 Ky investim i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, përveç mirëqenies qytetare, ofron dhe siguri më të madhe për banorët, projekte të cilat do të vazhdojnë edhe më tej.



25 tetor 2024

Në Qendrën Sportive "Sezai Surroi" në Prizren, sot u mbajtën Lojërat Sportive të organizuara nga Sindikata e Policisë së Kosovës, në shenjë nderimi dhe përkujtimi për zyrtarët policorë që kanë dhënë jetën e tyre në kryerje të detyrës, me ç'rast mori pjesë dhe nënkryetari Kujtim Gashi.

🌟 Kjo ngjarje u zhvillua në atmosferë solemniteti dhe solidariteti, ku kolegët, familjarët dhe qytetarët iu bashkuan nderimit për të rënë në mbrojtje të rendit dhe sigurisë publike.



26 tetor 2024

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural po vazhdon punimet në kuadër të projektit "Hapja e kanaleve për ujitjen dhe kullimin e tokave bujqësore", ku aktualisht po punohet në fshatin Krushë e Vogël, projekt ky që ka për qëllim ta përmirësojë sistemin e ujitjes për tokat bujqësore dhe të ofrojë mbrojtje ndaj vërshimeve të mundshme.



26 tetor 2024

Për nder të 150-vjetorit të lindjes së atdhetarit dhe humanistit shqiptar, At Shtjefën Gjeçovi, sot në fshatin Zym u mbajt edicioni i 53-të i manifestimit letrar "Takimet Gjeçovit".

✦ Në këtë aktivitet të veçantë e tradicional, në të cilin ishin të pranishëm edhe drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Adem Morina dhe kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Antigona Bytyqi, u theksua rëndësia e ruajtjes së veprës së Gjeçovit, që cilësohet si ikonë e kulturës dhe trashëgimisë, që ka dhënë një kontribut të çmuar në edukimin e brezave e në ruajtjen e vlerave tona kombëtare.



29 tetor 2024

Drejtoria e Shëndetësisë furnizoi sot Shërbimin Urgjent të Prizrenit me dy autoambulanca të reja, të cilat janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme mjekësore për përgjigje të shpejtë dhe efikase në rastet emergjente.

🏠 🚑 Këto autoambulanca dhe kujdesi mjekësor cilësor në kohë e ngrit edhe më shumë nivelin e sigurisë shëndetësore për të gjithë banorët e rajonit tonë.



30 tetor 2024

Drejtori i Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Ramadan Tarashaj, priti në punëtorinë e Komekut përfaqësueset e shoqatës “Gratë Burrnesha”, të cilat janë diagnostikuar me kancer dhe luftojnë për jetën e tyre.

● Ky aktivitet, i organizuar për muajin rozë, muajin e vetëdijesimit për kancerin, kishte për qëllim mbështetjen e këtyre grave duke u dhënë mundësinë të angazhohen në punime të ndryshme, të zhvillojnë aftësi të reja dhe të ndajnë përvoja për t’i përballuar sfidat.



31 tetor 2024

Kryetari Shaqir Totaj nënshkroi Memorandum Mirëkuptimi me Teach For Kosova për bashkëpunim rreth zbatimit të programit të Teach For Kosova në Komunën e Prizrenit, për implementimin e projektit “Promovimi i të menduarit kritik dhe qytetarisë aktive të rinjtë”, në kuadër të fushës së demokracisë dhe shoqërisë civile, me përkrahje financiare të National Endowment for Democracy, për krijimin e grupit të “Aktivizmit qytetar” brenda një shkolle të mesme në Komunë si dhe asistimit nga ana e Komunës për realizimin e projektit në mënyrë sa më cilësore.

